

Vendim nr. 124 datë 08.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 08.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (M) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: METIJE ALLA

OBJEKTI: Shfuqizimi i shkresës nr.4271/1 prot., datë 18.04.2023 të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, z. Altin Dumani, për shpalljen e moskompetencës, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*);

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasja Metije Alla (*kërkuesja*) në datën 11.04.2023 ka depozituar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) kallëzimin penal ndaj shtetasit Avni Sejdi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nëpunësve publikë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Rurale 2, Tiranë, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga nenet 248 dhe 28/4 të Kodit Penal (*KP*).

2. Kallëzimi penal ndaj gjyqtarit Avni Sejdi ka lidhje me gjykimin e kërkesëpadisë të depozituar nga kërkuesja në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Referuar këtij kallëzimi ajo pretendon se nga ana e gjyqtarit janë kryer shkelje të rënda ligjore që konsistojnë në moszbatimin e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të ndryshuar dhe zbatimin e qëllimshëm të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), përpara ndryshimeve ligjore të pësuara me ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

3. Në vijim, Prokuroria e Posaçme, me shkresën nr. 4271/1 prot., datë 18.04.2023, ia ka përcjellë kallëzimin penal për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Shkresa e sipërpërmendur i është dërguar për dijeni edhe kërkueses. Referuar kësaj shkrese, Prokuroria e Posaçme ka konstatuar se në kallëzimin penal të kërkueses nuk ofrohet asnjë e dhënë ose indicie që të mbështesë pretendimet e saj për vepra penale me elemente korruptive, të evidentohen elemente të figurave penale, të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) ose ku autorë të mundshëm të veprës penale të jenë subjekte, për hetimin e të cilëve kjo prokurori është kompetente. Në këto kushte, Prokuroria e Posaçme ka vlerësuar se duhet të kryhen verifikime të mëtijshme për faktet e pretenduara nga kërkuesja, në lidhje me sjelljen/veprimet e kundërligjshme të pretenduara se janë kryer nga gjyqtari Avni Sejdi dhe nga nëpunësit publikë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Rurale 2, Tiranë, të cilat, nga të dhënat e ofruara, aktualisht, orientohen në drejtim të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së.

4. Kërkuesja, duke mos qenë dakord me shkresën nr. 4271/1 prot., datë 18.04.2023 të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), në datën 02.05.2023, me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e saj, si të papajtueshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuases

5. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

5.1. *E drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe e drejta e ankimit*, pasi ligjvënësi nuk ka parashikuar ankimin për shpalljen e moskompetencës lëndore nga organi i prokurorisë, por ka parashikuar aplikimin e dispozitave detyruese të neneve 9/a, 24, 25 dhe 84 të KPP-së nga organet e hetimit, të cilat nuk janë zbatuar nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke penguar zbatimin e ligjit. Legjislacioni nuk parashikon mjete ligjore për shpalljen e moskompetencës lëndore në mënyrë të drejtpërdrejtë nga drejtuesi i kësaj prokurorie, nëpërmjet një shkrese që qëndron ndërmjet një akti procedural penal dhe një akti procedural administrativ. Shkresa e Prokurorisë së Posaçme për shpalljen e moskompetencës lëndore është antikushtetuese dhe moszbatimi i dispozitave të KPP-së nga kjo prokurori ka sjellë, si pasojë, shkeljen e të drejtave kushtetuese që garantohen nenet 15 dhe 17 të Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuases.

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësja të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se kërkuësja kundërshton shkresën e Prokurorisë së Posaçme për dërgimin e kallëzimit të saj penal për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sipas saj, kjo shkresë, në thelb, u ka hequr kompetencën strukturave të specializuara, duke ia kaluar çështjen për kompetencë prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm, për pasojë asaj i janë ulur garancitë kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave.

9. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji mban në konsideratë se aktet e nxjerra nga prokurori (shkresa) për përcaktimin e kompetencës, por edhe vendimet gjyqësore që shqyrtojnë ankime të këtyre rasteve (pavarësisht se në rastin konkret nuk ka vendime gjyqësore që kanë shqyrtuar çështjen), kanë natyrë të ndërmjetme në procedimin penal që po zhvillohet, pasi nuk e zgjidhin në themel çështjen e saj (*shih vendimet nr. 178, datë 15.12.2022; 180, datë 15.12.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*). Në rastin konkret, procedimi penal i vënë në lëvizje nga kërkuesja me kallëzimin penal ndaj gjyqtarit Avni Sejdi dhe nëpunësve publikë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Rurale 2, Tiranë është ende në vijim, në fazën e hetimeve paraprake.

10. Duke zbatuar standardet kushtetuese të mësipërme, Kolegji vlerëson se shkresa e kundërshtuar nuk konsiderohet përfundimtare për qëllim të kontrollit kushtetues dhe se kërkuesja i ka të gjitha mundësitë që pretendimet me natyrë kushtetuese t'i paraqesë si gjatë procedimit penal në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm deri në Gjykatën e Lartë, ashtu edhe në kundërshtimin eventual të vendimit përfundimtar në këtë Gjykatë.

11. Për sa më sipër, Kolegji çmon se kërkuesja nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për kundërshtimin e aktit të prokurorit, pasi, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ajo ka ende mjete juridike efektive në dispozicion për shterimin e të drejtave të pretenduara si të cenuara. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

12. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.